

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-departamenti I per gjithshem-divizioni civil, Enes Mehmeti dhe procesmbajtesja Minire Krasniqi, sipas padise se [REDACTED] Prishtine te cilin e perfaqeson [REDACTED] kunder te paditurit [REDACTED] nga Ferizaj, per borxh, ne séance e mbajtur me date 22.05.2014, ne pranine e perfaquesues se paditeses a ne mungese te te paditurit, ne te njejten dite, merr kete

A K T G J Y K I M

APROVOHET kérkesëpadia e paditëses [REDACTED] Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj , qe paditëses në emër të shfrytezimit te sherbimeve te telefonise fikse t'a paguan shumën prej 347.30 €, te gjitha keto ne afat prej 7 ditesh, pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykiti.

A r s y e t i m i

Pretendimet e padise se paditeses mbeshtetet ne faktin se i padituri ka shfrytezuar rregullisht sherbimt telefonise fikse nderksaq per te njetjet nuk ka permbushur detyrimet ndaj paditeses, kete e ka deshmuar me faturat e prezantuara dhe ate per periudhen nga muaji 05 deri 12 te vitit 2005.

I padituri ndonese ka qene i ftuar me rregull per séance e shqyrtimit kryesor i njejti nuk eshte paraqitur ne séance dhe mungesen nnuk e ka arsyetur, ndja gjykata ka vendosur qe séance ta mbante ne mungesen e tij ne pajtim me nenin 423.4 te LPK_se.

Gjkata mei qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjesfaktikët të cështjes, për aq sa palët ndërgjgyjëse i parashtruan ato në ketë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë adminisritimin e provave si vijojnë:

Faturat e leshuara nga paditesja per te paditurin per muajin e 5 deri ne muajin 12-te per vitin 2005 dhe per periudhen 01.04.2006 .

Gjkata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre vec e vec si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 parg.1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Gjkata nga shqyrtimi i gjithmbarshem i fakteve dhe provave te ceshtjes ka gjetur se kerkespadia e paditeses eshte e bazuar .

Gjkata ka vertetuar faktin se në mes paleve ndrygjygjese ka patur marredhenie kontraktuale perkitazi me shfrytezimin e sherbimeve telefonike per numrin e telefonit 20-782 dhe se i padituri ka shfrytezuar sherbimet telefonike te paditeses, per te cilat edhe eshte faturuar.

Gjkata vë në pah faktin se dokumentet, ne rastin konkret faturat e te paditeses, jane leshuar ne kuader te autorizimeve publike qe ka paditesja ka si kompani publike dhe sit e tilla paraqesin prova te besueshme dhe eventualisht rrezueshmeria e tyre do duhej provuar nga pala e paditur, dhe se ne kete

kontekst eshte evident edhe supozimi ligjor se i padituri eshte dashur qe te permbush detyrimet per sherbimet e faturuara, meqenese gjendja e tille reflekton faktin se i padituri ka pranuar se ka patur marredhenie kontraktuale per shfrytezimin e sherbimeve telefonike dhe per te vazhdimisht eshte faturuar nga paditesja per sherbimet e marra, per te cilat pretendon se i ka permbushur, madje pretendon te arsyetoj kete me parashtrimin e kunderhstimit te parashkrimit te kerkesave te paditeses.


Gjykata vlereson se i padituri ka obligimin qe tia permbush detyrimin si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi paditeses, duke qene se l njejt nuk ka mundur te provoj pagesen e sherbimeve qe ka shfrytezar, ndersa pretendimet e tij per parashkrimin e kerkeses jane te pabazuara per faktin se paditesja brenda aftit kohor ka paraqitur kerkesen per realizimin e se ciles ka inicuar propozim per permbarim ne baze te dokumentit te besueshem dhe vetem pas parashtrimit te kundershtimit e njejt ak marr karakter padie.

Pretendimet e te paditurit se ai ka permbushur me kohe te gjitha detyrimet ndaj paditeses gjykata nuk l ka aprovuar si te bazuara meq ka qene ne detyren e te paditurit qe te provoje faktet perkitazi me pretendimin per pagesen e te gjitha sherbimeve qe ka shfrytezar nga paditesja. Kete detyre e ka patur i padituri ne baze te rregullave mbi te provuarit te fakteve.

Ndaj mbi bazen e parashtrimeve te me siperme eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr350/11 date 22.05.2014



Keshilla Juridike: Kunder ektij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 7 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij, ne gjykaten e Apelit ne Prishitne, permes kesaj gjykate.

REPUBLICA KOSOVES



REPUBLICA KOSOVES

VENDIMI ESHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROSEVAC

